



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 1215/5 prot.

Tiranë, më 20.06.2025

VENDIM

Nr. 17, datë 20.06.2025

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”), është administruar ankesa me nr. 1215 prot., datë 15.04.2025, nga _____, përfaqësuar nga z. _____, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Agjencia Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve dhe Lehtësuesve” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e kërkuarit, nëpërmjet kërkesës për informacion datë 01.04.2025, depozituar në adresën elektronike info@startupalbania.gov, ka kërkuar t’i vendoset në dispozicion informacioni/dokumentacioni, në lidhje me:

1. Listën përfundimtare të aplikantëve fitues dhe jo fitues, së bashku me;
2. Pikët totale të grumbulluara nga secili aplikant;
3. Vlerësimi për secilën kategori kriteresh;
4. Renditja përfundimtare sipas pikëve për të gjithë aplikantët e thirrjes;
5. Procesverbali ose çdo dokument zyrtar që ka miratuar përzgjedhjen përfundimtare të fituesve;
6. Përbërja e Komisionit Vlerësues përgjegjës për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve;

7. Rivlerësim të aplikimit.

Autoriteti Publik me anë të shkresës nr.154/1 prot., datë 10.04.2025, si dhe nëpërmjet email-it info@startupalbania.gov.al datë 14.04.2025, ka kthyer përgjigje duke sqaruar se:

“Përgjigjja e dhënë nga institucioni ynë, përmes shkresës nr. 154/1 prot., datë 01.04.2025, është hartuar dhe përcjellë në përputhje të plotë me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 61, datë 07.02.2024, "Për miratimin e kërkesave dhe kriterëve që duhet të plotësojnë startup-et dhe lehtësuesit e startup-eve, të procedurave dhe afateve, si dhe të rregullave për përbërjen e Komisionit të Vlerësimit dhe Ankimit, kriterëve, procedurës së përzgjedhjes dhe shpërblimit të anëtarëve të tyre", i ndryshuar, si dhe në përputhje me Rregulloren "Thirrja për mbështetje të kompanive startup dhe lehtësuesve të startup-eve nëpërmjet granteve dhe masave mbështetëse 2025", interpretuar në mënyrë të detajuar, nen për nen. Sa i takon sistemit të pikëzimit, sqarojmë se totali prej 70 pikësh i referohet vlerësimit të dhënë për secilin aplikim nga një anëtar i Komisionit të Vlerësimit. Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë, dhe për rrjedhojë, numri maksimal i pikëve që mund të grumbullojë një subjekt është $70 \times 5 = 350$ pikë. Lidhur me informacionin mbi faqen zyrtare të institucionit, ju bëjmë me dije se Agjencia Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve dhe Lehtësuesve, në këtë moment, nuk disponon ende një faqe zyrtare në internet. Gjithashtu, theksojmë se faqja startupalbania.al nuk përfaqëson institucionin tonë dhe nuk është administruar apo menaxhuar nga ne. Në këtë kuadër, ju informojmë gjithashtu se publikimet dhe njoftimet zyrtare të nevojshme janë kryer në faqen zyrtare të Ministrisë të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, në adresën: <https://www.sipermarrja.gov.al>.”

Pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesi, ka paraqitur ankim pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të sipas kërkesës për informacion datë 01.04.2025.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”).

Në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”*, Komisioneri, me shkresën nr. 1215/1 prot., datë 17.04.2025, kërkoi nga Autoriteti Publik qëndrimin në lidhje me pretendimin e ngritur nga ankuesi brenda datës 24.04.2025.

Në vijim, me anë të email-it datë 18.04.2025, Autoriteti Publik ka rikonfirmuar qëndrimin e tij duke cituar se: *“...përgjigjet e dhëna si në adresën elektronike si në mënyrë shkresore, janë në përputhje të plotë me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.61, datë 7.2.2024 “Për miratimin e kërkesave e të kriterëve që duhet të plotësojnë start up-et dhe lehtësuesit e start*

up-eve, të procedurave e të afateve, si dhe të rregullave për përbërjen e komisionit të vlerësimit dhe ankimit, kritereve, procedurës së përzgjedhjes e të shpërblimit të anëtarëve të tyre”, Rregullores së Thirrjes për Mbështetjen Kompanive Startup nëpërmjet Granteve dhe Masave Mbështetëse” miratuar me Urdhërin nr.20 datë 2.12.2024 të Ministrisë të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit...”.

Pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesi me anë të email-it datë 29.04.2025, protokolluar me nr. 1215/2, ka vijuar me ankimin duke pretenduar se nuk ka marrë përgjigje për pikat:

“1. Listën përfundimtare të aplikantëve fitues dhe jo fitues, 2. Pikët totale të grumbulluara nga secili aplikant, 3. Vlerësimi për secilën kategori kriteresh, 4. Procesverbali ose çdo dokument zyrtar që ka miratuar përzgjedhjen përfundimtare të fituesve, 5. Përbërja e Komisionit Vlerësues përgjegjës për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve.”, duke hequr dorë nga ankimi për pikën 4 dhe 7 të kërkesës për informacion.

Në vijim të ankimit, Zyra e Komisionerit, nëpërmjet email-it datë 06.05.2025, ka kërkuar nga Autoriteti Publik të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion si dhe sqarime për disponimin e informacionit/dokumentacionit të kërkuar, duke rivlerësuar në këtë mënyrë kërkesën për informacion brenda datës 12.05.2025.

Autoriteti Publik, nëpërmjet email-it datë 13.05.2025, ka sqaruar se: *“...Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 61, datë 07.02.2024, “Për miratimin e kërkesave dhe kritereve që duhet të plotësojnë startup-et dhe lehtësuesit e tyre, të procedurave dhe afateve, si dhe të rregullave për përbërjen e Komisionit të Vlerësimit dhe Ankimit, kritereve, procedurës së përzgjedhjes dhe shpërblimit të anëtarëve të tyre”, të ndryshuar, si dhe në përputhje me Rregulloren “Thirrja për mbështetje të kompanive startup dhe lehtësuesve të startup-eve nëpërmjet granteve dhe masave mbështetëse 2025”, është parashikuar qartë se publikisht shpallet vetëm lista përfundimtare e përfituesve të grantit. Citojmë konkretisht dispozitën e Rregullores përkatëse mbi ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave: “Në bazë të Kodit të Procedurave Administrative dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, të dhënat personale dhe financiare të depozituara nga aplikuesit për qëllim të përfitimit nga granti, veçanërisht e gjithë korrespondenca e shkëmbyer, janë konfidenciale dhe nuk do të zbulohen. Staf i Agjencisë Startup Albania do të ruajë në mënyrë konfidenciale informacionet e marra nga startup-et. Asnjë e dhënë e marrë nga ana e aplikuesve nuk do t’u bëhet e ditur palëve të treta. Megjithatë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit, të dhënat në lidhje me identifikimin e aplikuesve të mbështetur, të dhënat e përgjithshme rreth buxhetit, financimit, aktiviteteve të kryera, rezultateve të arritura, ndikimeve dhe të tjera të ngjashme, mund të përdoren, publikohen ose shpërndahen nga stafi përgjegjës i Agjencisë pa ndonjë kufizim.” Në këtë kuadër, nënvizojmë se të gjitha dokumentet dhe informacionet që parashikohen të jenë objekt publikimi nga VKM nr. 61 dhe Rregullorja përkatëse janë tashmë të shpallura dhe të disponueshme për publikun. Gjithashtu, bazuar në Rregulloren (BE) 2016/679, përpunimi dhe publikimi i të dhënave personale mund të kryhet vetëm kur ekziston një bazë ligjore specifike, dhe vetëm nëse ky përpunim është i domosdoshëm, proporcional dhe transparent. Publikimi i të dhënave që nuk janë thelbësore për realizimin e interesit publik përbën shkelje të parimeve të mbrojtjes së të*

dhënave. Së fundmi, theksojmë se identiteti i anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit, procesverbalet e mbledhjeve, si dhe çdo material tjetër që përmban të dhëna personale, nuk bëjnë pjesë në informacionin e detyrueshëm për publikim, dhe ruajtja e konfidencialitetit të tyre është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe atë të Bashkimit Evropian në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe të drejtës për një administrim të paanshëm dhe të pavarur të procedurave konkurruese...”.

Në vijim, ankuesi, nëpërmjet email-it datë 13.06.2025, administruar me nr. 1215/4 prot., ka vijuar ankimin duke rikonfirmuar qëndrimin se nuk ka marrë përgjigje për pikat 1, 2, 3, 5 dhe 6 sipas kërkesës për informacion, datë 01.04.2025.

Në përfundim, pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI.

Në lidhje me pretendimin e Autoritetit Publik se, mosdhënia e informacionit të kërkuar bazohet në Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (Rregullorja (BE) 2016/679), Komisioneri thekson se kjo rregullore tashmë është pjesë e legjislacionit tonë të brendshëm, transpozuar nëpërmjet Ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nuk parashikon ndalim për dhënien e informacionit objekt shqyrtimi.

Në rastin konkret, Autoriteti Publik është duke vepruar në kuadër të një procedure konkurruese publike, që kërkon transparencë të procesit vendimmarrës.

Ndërkohë, referuar qëndrimit të Autoriteti Publik se: “...ruajtja e konfidencialitetit të tyre është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe atë të Bashkimit Evropian...”, Komisioneri thekson se, referuar jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të Drejtësisë dhe praktikës së autoriteteve të informimit në BE, identiteti i zyrtarëve publikë që marrin pjesë në vlerësimin e fondeve publike, nuk është informacion konfidencial, përderisa ata ushtrojnë një funksion publik.

Në rrethanat aktuale, përbërja e komisionit vlerësues përgjegjës për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve, si informacion i kërkuar, ka të bëjë me ushtrimin e funksionit zyrtar (emër, mbiemër), nga punonjës të autoriteteve publike që janë krijuar si strukturë e posaçme bazuar në VKM-në nr. 61 datë 07.02.2024 “Për miratimin e kërkesave dhe kritereve që duhet të plotësojnë startup-et dhe lehtësuesit e tyre, të procedurave dhe afateve, si dhe të rregullave për përbërjen e Komisionit të Vlerësimit dhe Ankimit, kritereve, procedurës së përzgjedhjes dhe shpërblimit të anëtarëve të tyre”, të ndryshuar.”

Gjithashtu, në pikën 2 të nenit 44 të Ligjit 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, parashikohet se: “...Aksesi i publikut në informacionin publik, siç përcaktohet në ligjin nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, dhe aksesit i publikut në informacionin

që lidhet me kryerjen e funksioneve dhe të detyrave zyrtare, nuk pengohet nga e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale të personave fizikë, të cilët konsiderohen si autoritete

publike ose ushtrojnë funksione shtetërore, përveç rasteve kur të drejta të tjera themelore, si e drejta e tyre për jetën ose e drejta e tyre për integritet fizik e mendor kërkojnë mbrojtjen e të dhënave të tyre në një rast ose kategori të caktuar rastesh...”

Nga ana tjetër, përkufizimi i termi “Zyrtar” përcaktohet specifikisht në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*”, i ndryshuar, sipas të cilit “Zyrtar” është çdo person, që kryen detyra dhe ushtron funksione publike. Gjithashtu sipas parashikimit të nenit 4 të po këtij ligji, brenda sferës së këtij përkufizimi përfshihet çdo zyrtar që merr pjesë në një vendimarrje.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, procesi i dhënies së granteve si një procedurë administrative ka interes publik. Qëllimi i këtij procesi është mbështetja e subjekteve private nëpërmjet fondeve shtetërore dhe garantimi i një konkurrence të ndershme dhe transparente. Kjo e bën të detyrueshëm publikimin e kriterëve dhe metodologjisë së vlerësimit, transparencën mbi rezultatin përfundimtar për çdo aplikant, si dhe publikimin e anëtarëve të Komisionit Vlerësues dhe akteve që mbështesin vendimarrjen.

Ndërkohë, nga ana tjetër LDI rregullon dhënien e aksesit në informacionin publik për çdo person të interesuar. Ky ligj, në nenin 17 të tij përcakton dhe rastet kur dhënia e informacionit jepet në mënyrë të kufizuar. Në këto raste, Autoriteti Publik duhet të tregojë qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që refuzohen, si dhe në bazë të cilës pikë të nenit 17 bëhet ky refuzim. Nga verifikimi i përgjigjes së Autoritetit Publik, nuk rezulton të jetë argumentuar refuzimi i kërkesës në përputhje me këtë nen.

Në vlerësim të Komisionerit, informacionet që kanë të bëjnë me pikët, renditjen, përbërjen e komisionit dhe vendimarrjen zyrtare janë me interes publik, të rëndësishme për ruajtjen e integritetit të procesit administrativ, pa element të kufizimit, pasi i referohen akteve zyrtare të një autoriteti publik në një proces konkurrimi të hapur. Dhënia e informacionit të kërkuar nuk është vetëm detyrim ligjor formal, por një garanci themelore për transparencën dhe integritetin e proceseve publike.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, në kushtet kur Autoriteti Publik pranon zotërimin e informacionit, ai rrjedhimisht përmbush kriteret e pikës 2, të nenit 2 të LDI, në të cilën parashikohet se: “*Informacion publik është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik*”. Në këto kushte, Autoriteti Publik duhet të vendosë në dispozicion të kërkuarit/ankuesit informacionin në formatin e zotëruar, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të LDI.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforsimin e integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti që ushtron funksione publike.

Ndërkohë pika 3, e nenit 3 e LDI parashikon se: “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 1215 prot, datë 15.04.2025, vijuar me ankimin nr.1215/4 prot., datë 13.06.2025, nga _____, përfaqësuar nga z. _____, kundër Autoritetit Publik “Agjencia Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve dhe Lehtësuesve”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit, sipas vijimit të ankimit nr.1215/4 prot., datë 13.06.2025 konkretisht: 1. Listën përfundimtare të aplikantëve fitues dhe jo fitues, 2. Pikët totale të grumbulluara nga secili aplikant, 3. Vlerësimi për secilën kategori kriteresh, 4. Procesverbali ose çdo dokument zyrtar që ka miratuar përzgjedhjen përfundimtare të fituesve, 5. Përbërja e Komisionit Vlerësues përgjegjës për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve, në formatin e zotëruar, duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, brenda datës 27.06.2025.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 20.06.2025.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi